



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2023:107096
Datë: 15.03.2024
Numri i dokumentit: 05457284

C.nr.2763/2023

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin Përparim Zeka, në çështjen juridike kontestimore të paditëses F. A. nga Prishtina, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson avokat B. U. nga Prishtina, kundër të paditurës Komuna e Prishtinës – Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt kontesti kompensim i orëve mbi normë, jashtë seancës, me datë 15.03.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditëses F. A. nga Prishtina dhe DETYROHET e paditura Komuna e Prishtinës – Drejtoria Komunale e Arsimit në Prishtinë, që paditëses në emër të kompensimit të orëve mbi normë për periudhën kohore prej vitit 2020/2021 deri në 21.11.2022, t'ia paguaj 30% rritje të pagës bazë (paga bazë 421.00€) për 119 orë, shumën prej 812.77€, si dhe në emër të kompensimit të orëve gjatë vikendeve prej vitit 2020/2021 deri në 21.11.2022, t'ia paguaj 50% rritje të pagës bazë (paga bazë 421.00€) për 56 orë, shumën prej 441.84€, apo shumën e përgjithshme prej 1,254.61€.

II. DETYROHET e paditura Komuna e Prishtinës – Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditëses t'ia paguaj kamatën në lartësi prej 8%, nga data e ushtrimit të padisë datë 12.05.2023 deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 124.00€, e të gjitha në afat prej 7 ditësh nga marrjes së aktgjykimit.

A r s y e t i m

Paditësja përmes të autorizuarit të saj, pranë kësaj gjykate, me datë 12.05.2023, kanë parashtruar padi kundër të paditurës, me objekt kontesti kompensim e orëve mbi normë. Në padi dhe në precizimin e datës 09.01.2024 ka theksuar se paditësja është e punësuar tek e paditura në SHFMU “Hasan Prishtina” në Prishtinë. Tutje ka shtuar se paditësja i plotëson kushtet për përfitimin e kompensimit e orëve mbi normë, e drejt kjo e garantuar sipas Kontratës Kolektive të Arsimit të Kosovës neni 11 par.10, nenit 35 par.4 dhe Ligjit të Punës neni 56 par.2 pika 2.3 dhe 2.5. Më tej ka theksuar se paditëses nuk i'u është bërë kompensimi i orëve mbi normë për periudhën nga viti 2020/2021 e deri më 21.11.2022, në vlerën e 30% rritje të pagës bazë për 119 orë mbi normë apo shumën prej 812.77€, si dhe kompensimin e orëve gjatë vikendeve për periudhën 2020/2021 deri në 21.11.2022, në vlerën e 50% të rritje të pagës bazë apo për 56 orë pune, t'ia paguaj shumën prej 441.84€, me kamatë ligjore 8% nga data e parashtrimit të padisë e deri në pagesën definitive, duke kërkuar nga gjykata që të aprovohet në tërësi kërkesëpadia si e bazuar.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

I padituri në përgjigjen në padi ka theksuar se e konteston në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses, për arsye se një kompensim i tillë nuk është paraparë as me Ligjin e Punës nr.03/L-212. Po ashtu e paditura gjatë përgatitjes së buxhetit nuk ka paraparë në skemën e saj buxhetore, linje të veçantë buxhetore për këto lloje të kompensimeve. Prandaj, ka kërkuar nga gjykata pas administrimit të provave kërkesëpadinë e paditëses ta refuzoj në tërësi si të pabazuar.

Lidhur me shpenzimet e procedurës nuk është deklaruar.

Pasi që Gjkata bëri vlerësimin e provave të bashkangjitura padisë, si dhe pas pranimit të përgjigjes në padi, mbështetur në nenin 8 dhe 398 të LPK-së, ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet ligjore për marrjen e aktgjykimit jashtë seancës, sepse në mes të palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, por se e paditura ka ngritur çështje që kanë të bëjnë me pamundësinë e përmbushjes së detyrimit. Në këtë rast kontestues është vlerësuar se nuk ka pengesa në kuptim të dhënies së vendimit meritor jashtë seance.

Nga provat e bashkangjitura padisë gjykata gjeti se paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura, sipas kontratës të datës 01.09.2016.

Gjkata përmes vërtetimit të datës 27.02.2023, gjeti se paditësja për periudhën kohore nga viti 2020/2021 e deri më 21.11.2022 ka gjithsej 119 orë mbi normën të realizuara, ndërsa 56 orë mbi normë të realizuara i ka të shtunëve.

Nga provat e administruara si më lartë, gjykata gjeti se paditësja nuk ka pranuar kompensimin të orëve mbi normë, në kohën sa ka qenë në fuqi KKAK.

Nga vërtetimi i gjendjes faktike, vërehet se paditëses për periudhën kohore nga viti 2020/2021 e deri më 21.11.2022 në emër të kompensimit të orëve mbi normë i takon rritje 30%, të pagës bazë (paga bazë 421.00€ : 80 orë të rregullta përfitohet shuma 5.26€) nga e cila shumë i shtohet 30% që i bijnë të jetë 1.57€, apo në shumë prej 6.38€ për orë shumëzuar për 119 të orëve mbi normë përfitohet shuma prej 844.78€.

Këtë lloj kompensimi gjykata i'a njohu paditëses në harmoni me nenin 11 par.10, të KKAK-së, ku është paraparë se: "Mësimdhënësit gëzojnë të drejtën për punë mbi normë të paguar deri 30% të ngarkesës mësimore" ndërsa me nenin 35 par.4 është përcaktuar se: Kur mësimdhënësit dhe punonjësit tjerë arsimorë kryejnë orë mësimi mbi ngarkesën mësimore mujore, të parashikuar me këtë kontratë, orët mbi normë i paguhen sipas dispozitave ligjore e nënligjore në fuqi (si ortë të rregullta).

Ndërsa sa i përket kompensimit të orëve mbi normë gjatë vikendeve vërehet se paditësja për periudhën kohore nga viti 2020/2021 deri në 21.11.2022 i takon rritje prej 50% të pagës bazë (paga bazë 421.00€ : 80 orë të rregullta përfitohet shuma prej 5.26€) nga e cila shumë i shtohet 50% që i bie të jetë 2.63€ apo në shumën prej 7.89€ për orë shumëzuar për 56 të orëve mbi normë gjatë vikendit përfitohet shuma prej 441.84€. Këtë lloj kompensimi gjykata i'a njohu në harmoni me nenin 35 par.3 ku është paraparë se : "Pagat e punëtorëve të sistemit arsimor përcaktohen me akte nën ligjore në fuqi. Për ndryshimet dhe shtesat, plotësimet dhe rritjet e mëtejshme të pagave të punonjësve të sistemit të arsimit, punëdhënësi është i detyruar

që në procesin e hartimit të buxhetit të çdo viti të konsultohet dhe të marrë mendimin e SBASHK-ut, nënshkruet të kësaj kontrate kolektive, përpara se propozimet përkatëse të dorëzohen në Qeveri për miratim”, kurse me nenin 56 par.2 pika 2.5 të Ligjit të Punës është përcaktuar se: “Të punësuarit i takon paga shtesë në përqindje të pagës bazë, 50% në orë për punë gjatë fundjavës”.

Gjykata duke ju referuar Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK), të nënshkruar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës dispozitat e së cilës aplikohen në tërë Republikën e Kosovës, ku në nenin 11 par.10 dhe 35 par. 3 dhe 4 dhe Ligjit të Punës është paraparë e drejta punëtoreve të arsimit në kompensimin të orëve mbi normë, gjeti se e njëjta është e aplikueshme nga hyrja në fuqi me datë 18.04.2017. Pas skadimit të kësaj kontrate, është nxjerrë kontrata e re, e cila i’u garanton punonjësve të arsimit këto të drejta.

Nga të lartcekurat gjykata ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e aktgjykimit aprovues jashtë seance, në kuptim të nenit 398 i LPK-së, sipas të cilit “Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”. Duke qenë se ka lindur e drejta e paditëses për të kërkuar në rrugë gjyqësore realizimin e të drejtës për kompensimi e orëve mbi normë, e njëjta është legjitimuar që të kërkojë përmbushjen e detyrimit nga e paditura, së këndejmi, paditësja e ka rolin e kreditorit kurse e paditura rolin e debitorit. Në kuptim të nenit 245 të Ligjit nr. 04/L-077 për marrëdhëniet e detyrimeve: “Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”. Rrjedhimisht, duke qenë se e paditura i ka mbetur borxh paditëses, me aplikimin e dispozitës së lartcekur dhe në bazë të gjendjes së vërtetuar faktike, vendosi që ta detyroj të paditurën që paditëses t’ia kompensoj shumat si në dispozitiv të aktgjykimit.

Sa i përket kundërshtimeve të paditurës me përgjigje në padi, gjykata vlerëson se të njëjtat nuk janë të bazuara mbi dispozitat ligjore dhe nuk mbështeten në ndonjë bazë faktike apo juridike, sepse e paditura nuk e konteston bazën e kërkesës, e as lartësinë e kërkesës së paditëses, me anë të përgjigjes në padi. Ndërsa çështja e mënyrës së pagesës, respektivisht mundësisë së pagesës nga ana e të paditurës, se për këtë objekt të kërkesë e paditura nuk ka planifikuar buxhet dhe nuk kanë vijë buxhetore për ta realizuar këtë kompensim, nuk është rrethanë e natyrës juridike që ndikon për të marrë vendim ndryshe në këtë rast. Prandaj gjykata erdhi në përfundim se faktet në këtë rast, nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit meritor dhe se pala e paditur është obliguar ta përmbush obligimin ndaj paditëses.

Lidhur me lartësinë e kamatës së llogaritur prej 8%, gjykata vendosi në kuptim të nenit 382 të LMD-së, sipas të cilit Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën. Lartësia e kamatëvonesës është tetë për qind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë, e do të llogaritet nga dita e parashtrimit të padisë datë 12.05.2023.

Gjykata vendosi si në dispozitivin e II të këtij aktgjykimi, ashtu që e paditura të paguaj shpenzimet e procedurës në lartësi prej 124.00€, në kuptim të nenit 452 të LPK-së. Lartësia e

shpenzimeve i referohet shpenzimeve për përpilimin e padisë në shumë prej 104.00€ - sipas tarifës së OAK dhe taksa gjyqësore në shumë prej 20.00€.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË
Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.2763/23, datë 15.03.2024

Gjyqtari
Përparim Zeka

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së te njëjtit, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.